



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
19.11.2019, duke filluar në orën 15:00

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Valbona Petrovci, e pavarur, Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha, i pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR) dhe Rifat Deri, i pavarur.

Munguan: Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Florida Canolli (PDK), Adelina Fazliji (AKR), Vlora Dumoshi (LDK), Visare Gashi (PSD) Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe: drejtorë të drejtorive të Komunës së Prishtinës, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, dhe propozoi këtë

REND DITE:

1. Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për buxhetin e vitit 2019.

Faqe 1 nga 2



Pika e parë

Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për buxhetin e vitit 2019.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi, Komuna e Prishtinës ka bërë rregullimin e ndarjes buxhetore për vitin 2019, ku vlera e investimeve kapitale nuk guxon të kalojë më shumë se 15%. Pra, sa për njoftim, kjo nuk është bartje, por është rregullim i ndarjeve buxhetore. Vlera e cila na duhet për pagesën e pjesës së dytë të IMN "Kosova" për 20%, është në vlerë prej 2 milionë e 321 mijë e 623 euro. Pra, tani është pjesa e dytë, të cilën jemi të obliguar ta paguajmë.

Halim Halimi ngrit shqetësim rreth ndarjeve buxhetore, duke thënë se të merren mjete prej linjave të tjera buxhetore, siç është ajo e parqeve, kur e dimë sa na mungojnë neve parqet në komunën e Prishtinës, dhe të destinohen në destinim krejt tjetër, është e pa qartë. Po ashtu, të merren mjetet prej projekteve për ndërtimin e rrugëve, sanimit të gropave etj., mendoj se kjo nuk qëndron. Ne do ta votojmë këtë propozimvendim, por duhet t'i keni parasysh këto vërejtje, se duhet të realizohen projektet të cilat parashihen në buxhet, për arsye se deri në fund të këtij viti mendoj se përsëri do të kemi mjete të pashfrytëzuara.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se edhe ne në parim e përkrahim propozimvendimin që të paguhet kësti i dytë dhe i tretë për 20%-shin e punëtorëve në llogari të AKP-së, për shpronësimin e IMN "Kosova", por me këtë ridestinimin nëpër kategori buxhetore të propozuara, a do të thotë që parqet dhe lodrat do të mbesin pa mirëmbajtje.

A do të thotë që do të mbesim pa tregun e ri që ka qenë i planifikuar të tenderohet, gjithashtu a do të mbesim edhe pa kamera në trafik. Të merren mjete prej kodeve të tjera buxhetore, sidomos nga projektet e parapara në infrastrukturën rrugore, si për ndërtimin e tyre, sanimin e gropave, mendoj se një bartje e tillë nuk qëndron.

Agim Gashi theksoi se Komuna e Prishtinës ka pasur mundësi ta planifikojë më mirë buxhetin dhe të parasheh edhe pagesën për IMN-në dhe të realizojë këto projekte shumë jetike për qytetarët e komunës së vet, por ajo nuk ka ndodhur, sepse është keq planifikuar dhe tani jemi të detyruar t'i bartim për pagesën e 20% për ish-punëtorët e IMN "Kosova".

Do të ishte mirë që secila drejtori, veç e veç, t'i shihet prioritetet e planifikuara, sepse ne kemi një Drejtori të Parqeve dhe shumica e mjeteve i barten dhe shkojnë për qëllime të tjera.

Pra, qëllimi është që së paku për vitin e ardhshëm buxhetor, të mos ndodhin këto farë përmbajtje buxhetore, sepse nuk është mirë, humbim ne, humb qeveria, humbin qytetarët e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për buxhetin e vitit 2019.

Mbledhja përfundoi në ora 15:35.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eëë.prishtina-komuna.org>

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

